

## **GJON NDREJAJ**



Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse ne Ministrinë e Mbrojtjes

Ka lindur në vitin 1950.

Eksperiencë pune: 42 vjet

Eksperiencë pune në KLSH (si specialist i jashtëm):  
1.5 vjet (2012-2013).

Fusha e ekspertizës: Çertifikuar si ekspert për auditimin dhe kontrollin e brendshëm

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DHE SFIDAT E PERFORMANCËS SË TIJ.<sup>i</sup>**

*nga Gjon Ndrejaj*

Nuk ka kaluar shumë kohë kur në kujtesën e profesionistëve por edhe të publikut, KLSH-ja shfaqej me një pamje apatike, një institucion që vepronte mbi praktika të vjetëruara, paçka se institucionet ndërkombëtare kishin nënvizuar nevojën e rishikimit të tyre dhe përjasjen me standardet ndërkombëtare. Mungesa e metodologjive bazë për zhvillimin e auditimit e kishte “gozhduar” këtë institucion në kuadrin e kontrolleve “ekonomiko financiare” sipas skemave të kontroll revizionit. Sjellja e institucionit ndaj subjekteve të audituara bazohej në represionin dhe herë-herë në abuzivizmin, ndërkohë ndërmjet tij, Kuvendit të Shqipërisë dhe publikut dominonte indiferenca dhe ata ishin të huaj për njëri tjetrin.

Ndryshimet në kreun e KLSH-së të dekretuara në fundin e vitit 2011, kanë sjellë ndryshime të dukshme të filozofisë së menaxhimit dhe të objektivave të këtij institucioni. Referuar kësaj filozofie, fokusi i veprimtarisë së institucionit, që përfaqësojnë edhe sfidat kryesore të tij, është përqendruar në luftën kundër korrupsionit dhe shtimin e vëmendjes për auditimin e performancës, si një mjet për të shtuar vlerën e parave publike.

Mandati i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, tashmë ka hyrë në vitin e dytë, ndërkohë ka ardhur koha për të bërë një farë bilanci të disa objektivave kryesorë të shpallura si dhe performancës së institucionit në tërësi.

### **Strategjitë, në bazë të zhvillimeve**

Duke vlerësuar situatën në këndvështrimin e mësipërm por edhe në zbatim të rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare si Komisioni European dhe instrumentet e tij SIGMA e DG Budget si dhe me mbështetjen e tyre, Kryetari i KLSH-së ka përpunuar politika të qarta të zhvillimit të institucionit për vitet e ardhshme me qëllim për ta vënë këtë institucion tërësisht në shërbim të Kuvendit të Shqipërisë dhe të interesit të taksapaguesve. Pikë së pari zhvillimet strategjike kërkonin një riformulim të misionit të KLSH-së përkundër misionit të mëparshëm, i cili e reduktonte misionin e këtij institucioni “në kontrollin e subjekteve dhe programeve publike” gjë e cila nuk ishte në një linjë me misionin e institucioneve supreme të auditimit të anëtarësuar në INTOSAI. Duke vlerësuar se misioni i një institucioni është formula bazë nga burojnë zgjidhjet dhe veprimtaritë e gjithë institucionit, KLSH është angazhuar që në kuadrin e hartimit të strategjive afat gjata të zhvillimit të riformulojë misionin e institucionit në përputhje me nevojat që shtrojnë zhvillimet strategjike të vendit tonë si dhe në mënyrë që ky institucion t’i kontribuojë në mënyrën më të mirë të mundshme këtyre zhvillimeve. Kështu po bëhen përpjekje që misioni i këtij institucioni të orientohet drejt informimit të publikut dhe Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përgjegjshmërinë e qeverisë dhe të enteve të tjera publike për përdorimin e burimeve publike sipas ligjit, me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë dhe nxitja e kësaj përgjegjshmërie në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikën më të mira të BE, me standardet ndërkombëtare të INTOSAI dhe me ndjeshmërinë popullore për shtimin e luftës kundër korrupsionit. Ky shënon një ndryshim të rëndësishëm në të gjithë filozofinë e menaxhimit të institucionit duke rritur kështu rolin e ekspertizës dhe të këshillimit për Kuvendin e Shqipërisë por edhe për gjithë sektorin publik në tërësi.

Orientimi i veprimtarisë së KLSH-së për nga vlerësimi i përgjegjshmërisë qeveritare kërkon ngritjen e nivelit të ekspertizës dhe marrjen e disa masave thelbësore që kanë të bëjnë me cilësinë e procesit të auditimit dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore. Duke ecur paralel me formulimin e qëllimeve strategjike por edhe në realizimin e tyre, vlerësojmë se hartimi i projektit të zhvillimit nga ana e KLSH-së dhe sigurimi i mbështetjes financiare në shumën prej 2.1 milion euro nga Komisioni European, i cili

fillon nga implementimi sipas të gjitha parashikimeve nga fundi i këtij viti, është një nga mekanizmat shumë të rëndësishëm për të mundësuar realizimin e misionit të KLSH-së në lidhje me vlerësimin e përgjegjshmërisë qeveritare. Ky projekt parashikon zhvillimin e kapacitetit institucional, të metodologjive të auditimit, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe mbështetjen me teknologji informacioni.

### **Ndryshimet strukturore kanë nisur**

Ndryshimi i filozofisë së menaxhimit ashtu si edhe misionit dhe objektivave strategjike të institucionit nuk do të mund të implementoheshin pa ndërmarrë ndryshime strukturore të vazhdueshme në përputhje me këto objektiva. Mjaft ndryshime strukturore janë realizuar kohët e fundit në këtë institucion por në këtë shkrim po ndalemi vetëm në disa prej tyre. Krijimi i departamentit të auditimit të performancës është një hap shumë i rëndësishëm, në linjë me objektivat e shpallura të Kryetarit të KLSH-së por edhe i matur dhe i sigurtë që ka filluar të japë frytet e para. Vlerësimi i përgjegjshmërisë qeveritare dhe informimi i publikut dhe Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me të, kërkon jo vetëm vlerësimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregullat të burimeve publike por edhe faktin, në se programet qeveritare sigurojnë maksimizimin e vlerës së parave publike, në se menaxherët që janë ngarkuar të qeverisin subjektet publike i kanë hartuar dhe zbatuar programet e tyre në përputhje me kriteret e kursimit , dobisë dhe frytshmërisë së burimeve publike. Objektivat e këtij departamenti janë mjaft ambicioze dhe synojnë trefishimin e auditimeve të performancës në krahasim me një vit parë. Kompletimi i departamentit me burime njerëzore të kualifikuara të përzgjedhura nga brenda institucionit por duke ftuar që të jenë pjesë e tij edhe ekspertë të jashtëm në zë të financave publike, tregon se ky objektiv është vënë dhe po ecën në rrugën e duhur.

Përfaqja e veprimtarisë së auditimit në tërësi, me praktikat më të mira të institucioneve homologe të auditimit kërkon në radhë të parë krijimin dhe zhvillimin e metodologjive të auditimit në mënyrë të tillë që të reflektohen standardet ndërkombëtare të auditimit. Në se në të kaluarën kjo përgjegjësi kaq e rëndësishme nuk ishte e adresuar saktë tashmë është krijuar një departament i veçantë përgjegjësi e të cilit është kërkimi shkencor dhe zhvillimi i institucionit bazuar në standardet ndërkombëtare. Duke i hedhur një sy produkteve të këtij departamenti vlerësohet se ai ka koordinuar mjaft mirë çështje të tilla si ato me karakter zhvillimor, metodologjik dhe strategjik

të institucionit. Institucioni është tashmë i gatshëm t'i nënshtrohet zhvillimeve të ardhshme që kanë të bëjnë çertifikimin e auditëve, zhvillimin e metodologjive për fusha të caktuara si ato të auditimit të performancës, politikat e zhvillimit të burimeve njerëzore etj. Hartimi i metodologjive i vlerësuar në lidhje të ngushtë me implementimin e tyre nuk do të kishte qenë i suksesshëm nëse këto përgjegjësi nuk do të ishin adresuar në struktura të veçanta. Ashtu siç edhe dihet rritja e profesionalizmit të stafit është parë si një mjet i rëndësishëm për të realizuar sfidat me të cilat përballlet institucioni. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe vendosja e një standardi për trajnimin e vazhdueshëm profesional të stafit e shoqëruar kjo me testimin e njohurive të fituara nga trajnimi. Vendosja e normës së trajnimit mesatarisht prej 80 orë trajnimi në vit e diferencuar për stafin ekzistues dhe të ri e ka orientuar gjithë stafin nga përditësimi i njohurive në lidhje me auditimin dhe disiplinat e tjera relevante. I gjithë ky proces zhvillohet sipas një plani të hartuar në fillim të vitit rrjedhojë e vlerësimit të nevojave për trajnim dhe është përgjegjësi e strukturës së veçantë të krijuar enkas, brenda Departamentit të Burimeve Njerëzore.

#### **Rezultatet e para tashmë janë evidente.**

Në kuadër të arritjes së këtyre objektivave e sfidave, rezultatet e deritanishme janë impresionuese. Proçesi dhe objektivat e auditimit të performancës po ecin sipas parashikimeve. Ky departament e ka mbështetur veprimtarinë e tij në udhëzuesin e performancës të INTOSAI i cili tashmë është në duar të audituesve i përshtatur në versionin shqip. Auditimi performancës në Shërbimin Hekurudhor Shqiptar provoqi se stafi i këtij departamenti e ka kaluar me sukses provën e sigurisë së tij. Gjetjet e këtij auditimi kanë evidentuar qartë faktin se shërbimi hekurudhor jo vetëm që nuk plotëson pritshmëritë e përdoruesve të tij por po shkon në kah të kundërt me to. Konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi janë një bazë e mirë për të mbështetur vendimmarrjet e qeverisë për të ristrukturuar shërbimin e transportit hekurudhor dhe për ta bërë atë më efektiv dhe eficient. Auditime të tjera në fusha dhe programe qeveritare janë projektuar dhe kanë filluar të kompletohen dhe pritet që rekomandimet e tyre gjithashtu të ndikojnë vendimmarrjet qeveritare në interes të përdorimit burimeve publike me kursim, efektivitet dhe efikasitet.

Arritje të rëndësishme janë evidentuar në rritjen e rolit antikorrupsion të KLSH-së si një nga sfidat kryesore të këtij institucioni. Edhe pse standardet

ndërkombëtare të auditimit janë të kujdesshme dhe disi të rezervuara kur bëhet fjalë për rolin antikorrupsion të institucioneve të auditimit, KLSH-ja duke ju referuar ndjeshmërisë popullore në lidhje me këtë fenomen e ka orientuar veprimtarinë e auditimit në fushat që kanë një ekspozim të lartë ndaj rrezikut të korrupsionit. Kjo qasje e veprimtarisë së auditimit në fushat me rrezik të lartë korrupsioni ka dhënë rezultate të prekshme në mbrojtjen e burimeve publike duke krijuar mundësinë e rikuperimit të dëmeve e shkeljeve dhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj qeverisjes. Vetëm për vitin 2012, KLSH ka referuar në prokurori 40 raste për vepra penale të dyshuara për 125 punonjës të administratës publike të niveleve të ndryshme, ose pothuajse 2 herë më tepër se sa tre vitet të marra së bashku (2009 -2011).

Progres i jashtëzakonshëm është evidentuar në fushën e trajnimit dhe formimit profesional. Kështu nga 2.1 ditë trajnimi për person të zhvilluara në vitin 2011, janë zhvilluar 19.4 ditë trajnimi për person gjatë vitit 2012 dhe po punohet me të njëjtin ritëm edhe gjatë vitit 2012. Ndryshime të rëndësishme kanë pësuar jo vetëm vëllimi i trajnimit por edhe struktura e tij. Disiplinat për të cilat trajnohen audituesit përfshijnë fusha të ndryshme relevante të lidhura me auditimin si, legjislacioni, qeverisja, financat publike etj. Nga ana tjetër bie në sy fakti se një pjesë e konsiderueshme e trajnerëve kanë qenë ekspertë të huaj me eksperiencë të madhe në fushën e auditimit. Përveç kësaj audituesit kanë prekur nga afër përvojat e huaja nëpërmjet vizitave studimore dhe trajnimeve një javore në vende të tilla si Polonia, Sllovenia, Turqia, Kosova etj. Për të evidentuar ritmin e ndryshimeve në këtë fushë mjafton të përmendim faktin se gjatë vitit të kaluar janë dërguar për trajnime jashtë shtetit një numër audituesish të KLSH i barabartë me numrin e punonjësve të institucionit të dërguar jashtë gjatë shtatë viteve 2004-2011 të marra së bashku.

### **Pritshmëri të tjera....**

KLSH gjatë vitit 2012 me mbështetjen e partnerëve evropianë ka hartuar dhe paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë projekt ligjin “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i cili ka për qëllim përjasjen e veprimtarisë së institucionit me standardet ndërkombëtare të auditimit. Projekti parashikon shumë ndryshime në krahasim me ligjin ekzistues dhe synon rritjen e kapacitetit dhe të profesionalizimit të trupës së KLSH-së. Ndryshimet në këtë ligj janë të lidhura me shumë reforma të parashikuara në projektet zhvillimore të

financuara nga BE. Për fat të keq ky projekt ka mbetur i pashqyrtuar nga Kuvendi i Shqipërisë në këtë legjislaturë dhe rrezikon të bëhet pengesë në zhvillimin e ardhshme dhe ritmet e punës së institucionit.

Një numër i konsiderueshëm rekomandimesh për subjektin e audituar shoqërojnë raportet përfundimtare të auditimit, Duke patur parasysh faktin se në fund të fundit efektiviteti i auditimit matet me cilësinë e rekomandimeve dhe shkallën e pranimit dhe të zbatimit të tyre, institucioni i KLSH-së kërkohet të ngrëjë mekanizma e procedura të tilla ligjore që të sigurohet në një nivel të arsyeshëm për shkallën e pranimit dhe të zbatimit të rekomandimeve veçanërisht për ato me karakter të zhdëmtimit të shumave përkatëse. Nga ana tjetër duket se është e nevojshme dhe në sinkron edhe me misionin e ri të KLSH-së, një lobim i fortë në Qeveri dhe Kuvend për të hartuar një ligj në lidhje me përgjegjësinë materiale të menaxherëve publikë për vendimmarrjet e gabuara që shkaktojnë dëme interesave publikë. Kjo do të ndikojë dhe do të reduktojë dukshëm cilësinë e vendimmarrjeve që lidhen me përdorimin e burimeve publike dhe njëherit do të moderojë sjelljen e menaxherëve publikë në lidhje me funksionet e tyre e cila kështu hera herës paraqitet mjaft problematike.

---

<sup>i</sup>Botuar në gazetën “Ekonomia” datë 22 Maj, 2013

<sup>ii</sup> Shkrime të tjera të autorit (të papërfshira në këtë botim) gjatë vitit 2013:

- Auditimi i brendshëm dhe mbivendosja e strukturave (Ekonomia 12 shtator 2013)